



RAPORT PËRPARA KËSHILLIT TË PËRHERSHËM NGA KRYETARI I PREZENCËS SË OSBE-SË NË SHQIPËRI

31 tetor 2013

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Në një vit të mbizotëruar nga zgjedhjet parlamentare të 23 qershorit, zhvillimi paqësor i tyre, si dhe kalimi relativisht i qetë i pushtetit shënuan një përparim domethënës në Shqipëri, me gjithë mjedisin e vështirë politik dhe ekonomik. Megjithëse vërejti një “atmosferë mosbesimi midis dy forcave politike kryesore [që] njollosoi mjedisin zgjedhor”, raporti përfundimtar i misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve i Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) doli në përfundimin se zgjedhjet “ishin konkurruese, me pjesëmarrje aktive qytetare gjatë gjithë fushatës dhe respekt të mirëfilltë për liritë themelore”.¹

Viti i kaluar ka qenë një kohë zhvillimesh domethënëse në Shqipëri. Në fund të nëntorit, Shqipëria festoi 100 vjet pavarësi. Festimet ishin, gjithsesi, një çast i rrallë bashkues. Përparimi në axhendën e reformave ngeci, ndërsa armiqësia dhe polarizimi politik u rritën vazhdimisht me afrimin e zgjedhjeve parlamentare të 23 qershorit. Miratimi, në maj 2013, i dy ligjeve me shumicë të cilësuar, konkretisht i ligjit për Gjykatën e Lartë dhe atij për nëpunësin civil, si dhe i rregullores së Kuvendit, përmes bashkimit të votave të shumicës qeverisëse dhe opozitës, ishte një përjashtim për t’u shënuar.

Zgjedhjet e 23 qershorit nxorën fitues, me një diferencë të madhe, koalicionin e udhëhequr nga Partia Socialiste; koalicioni fitoi 83 vende, por për shkak të kapërcimit të mëvonshëm të një deputeti të opozitës, koalicioni i ri qeverisës tani ka 84 votat e nevojshme për të kaluar legjislacion me shumicë të cilësuar prej tri të pestash. Kalimi i pushtetit, që pasoi zgjedhjet, ishte relativisht i qetë, ndonëse jo krejtësisht pa akuza për shpërdorim pushteti nga ana e qeverisë në ikje dhe për spastrim të supozuar të administratës publike nga ana e qeverisë në ardhje.

Qeveria e re mori detyrën më 15 shtator, me një axhendë ambicioze. Megjithëkëtë, qeveria e re përballet me sfida të konsiderueshme, të cilat duhen trajtuar në një mënyrë të pjekur dhe gjithëpërfshirëse. Është pozitive që shumica e re ka shfaqur interesin e saj të fortë për të ecur përpara me reformat shumë të nevojshme dhe është zotuar të punojë bashkë me opozitën në këtë drejtim. Shpresohet që opozita do të përgjigjet në një mënyrë të favorshme për arritjen e përparimit në axhendën e reformave të vendit. Prezenca dhe bashkësia ndërkombëtare më gjerë kanë vijuar t’u theksojnë të gjitha palëve nevojën për t’u angazhuar plotësisht në institucionet demokratike të vendit. Klasa politike shqiptare ka rastin që të përqafojë një stil të freskët politik për të përballuar sfidat thelbësore dhe për të përmbushur aspiratat e qytetarëve të saj. Këto aspirata dhe vlerat që ato mbartin janë edhe të OSBE-së dhe Prezenca

¹ Raporti i plotë gjendet në faqen e ODIHR-it, te: www.osce.org/odihr/elections/106963

në Shqipëri ka një rol të spikatur për të luajtur në avancimin e tyre, duke ofruar përkrahje dhe partneritet.

Kjo klimë politike i dha trajtë Raportit të Progresit të vitit 2013 të Komisionit Evropian për Shqipërinë dhe “Komunikimin nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin Evropian” rreth strategjisë së zgjerimit, botuar më 16 tetor 2013 dhe kontribuoi në vendimin e Komisionit për të rekomanduar dhënien e statusit kandidat Shqipërisë, me mirëkuptimin që Shqipëria të vazhdojë të marrë masa në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Komisioni vuri në dukje se dialogu konstruktiv dhe i qëndrueshëm mes qeverisë dhe opozitës për reformat përkatëse do të jetë jetësor për përparim, sikurse edhe angazhimi konstruktiv në bashkëpunimin rajonal. Komisioni identifikoi pesë fusha përparësie kyçe, të cilat Shqipëria duhet t’i përmbushë për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit, konkretisht: të vijoje reformën në administratën publike; të forcojë pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore; të bëjë përpjekje të mëtejshme të vendosura në luftën kundër korrupsionit, përfshirë drejt vendosjes së një bilanci solid; të bëjë përpjekje të mëtejshme të vendosura në luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë drejt vendosjes së një bilanci solid; dhe të forcojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë të romëve, dhe politikën kundër diskriminimit, si dhe të zbatojë të drejtën e pronës. Këto përparësi pajtohen shumë me mandatin e Prezencës dhe përfaqësojnë fusha kyçe të pikave të forta dhe përvojës së Prezencës.

Prezenca është angazhuar herët dhe fort me qeverinë e re dhe është aktive me të gjithë aktorët politikë e më gjerë në shoqëri. Nga fundi i këtij viti, Prezenca i dha një vështrim të ri plotësisë me të cilën punon me partnerë të tjerë ndërkombëtarë, duke forcuar bashkërendimin dhe bashkëpunimin me BE-në, duke ofruar një marrëdhënie më të fortë me Këshillin e Evropës dhe Shtetet pjesëmarrëse dhe duke thelluar bashkëveprimin me OKB-në, duke siguruar që burimet e pakta të shkojnë aty ku mund të arrijnë efektin më të mirë dhe që përpjekjet tona të jenë bashkërisht përforcuese.

MJEDISI POLITIK DHE VEPRIMTARITË

Zgjedhjet e 2013-s qenë konkurruese, me pjesëmarrje aktive qytetare gjatë gjithë fushatës dhe respekt të mirëfilltë për liritë themelore, sipas vëzhguesve ndërkombëtarë të ODIHR-it, Asamblesë Parlamentare të OSBE-së dhe Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës. Gjithsesi, atmosfera e mosbesimit midis dy forcave politike kryesore njollosoi mjedisin zgjedhor dhe vështirësoi administrimin e gjithë procesit zgjedhor. Pas zgjedhjeve, udhëheqësi historik i Partisë Demokratike dhe kryeministri i atëhershëm, Sali Berisha, pranoi humbjen dhe dha dorëheqjen si kryetar partie, duke u hapur kështu rrugë zgjedhjeve për një kryetar të ri partie, të cilat u fituan me shumicë dërrmuese nga kryetari i bashkisë së Tiranës, Lulzim Basha. Qeveria e re, e udhëhequr nga kryeministri dhe kryetari i Partisë Socialiste Edi Rama, në koalicion me kryetarin e Kuvendit dhe kryetarin e Lëvizjes Socialiste për Integrim Ilir Meta, shpalli synimin e saj për t’u përqendruar te zhvillimi dhe reformat e nevojshme për të përmirësuar situatën politike, ekonomike dhe shoqërore në Shqipëri dhe për të arritur përparim të mëtejshëm në integrimin evropian të Shqipërisë.

Retorika nderëse dhe herë-herë përçmuese, që karakterizoi një pjesë të madhe të diskursit politik gjatë viteve të shkuara, nuk e rriti besimin e qytetarëve tek udhëheqja politike e vendit, institucionet apo procesi zgjedhor. Prezenca bëri përpjekje për ta zbutur atmosferën negative politike dhe për të rritur besimin e publikut në procesin zgjedhor. Një Kod Etike, i

hartuar nga Prezenca në partneritet me Presidentin e Republikës, për zhvillimin e një fushate zgjedhore etike, u përkrah në parim nga partitë, megjithëse është për të ardhur keq që nuk u pranua formalisht. Me mbarimin e zgjedhjeve, Prezenca i ka nxitur të gjitha palët, si në qeveri ashtu dhe në opozitë, që t'i përqendrojnë energjitë e tyre te përpjekjet e Shqipërisë për reformë. Prezenca u angazhua herët me anëtarët e qeverisë së re për të diskutuar dhe identifikuar mundësitë e bashkëpunimit dhe fushat e përparësisë. Ajo është angazhuar gjithashtu konsiderueshëm me opozitën, për ta nxitur të marrë pjesë aktivisht dhe me konstruktivitet në promovimin e institucioneve demokratike të Shqipërisë, që është një pjesë thelbësore e çdo demokracie funksionale. Përgjigja nga të gjithë aktorët politikë ka qenë tejet pozitive, duke theksuar rolin e Prezencës si partnere e fortë dhe përkrahëse e vendit. Megjithatë, duket se po lindin fusha të reja tensioni politik, duke qenë se opozita nuk ka pranuar të marrë pjesë në disa nga punimet e Kuvendit.

Me gjithë përmirësimet në respektin e të drejtave të njeriut, Prezenca vijon të ketë një rol për të luajtur për të tërhequr vëmendjen dhe mbështetur zgjidhjet ndaj problemeve në këtë fushë. Dëbimi i disa familjeve rome, në fillim të gushtit 2013, është një rast i tillë. Prezenca ishte ndër të parët që vuri në dukje gjendjen e vështirë të familjeve dhe bëri thirrje për një reagim të përshtatshëm institucional; menjëherë më pas, Amnesty International u bëri thirrjeve autoriteteve që të siguronin strehim alternativ sipas detyrimit që rrjedh nga standardet ndërkombëtare për dëbimet për shkak të zhvillimit. Prezenca ka qenë aktive edhe në prapaskenë, duke shqyrtuar zgjidhje afatshkurtra dhe afatmesme me qeverinë, bashkinë, Avokatin e Popullit dhe organizatat që punojnë në këtë fushë, me qëllimin për të gjetur një zgjidhje sa më të shpejtë për familjet e prekura. Veprimet konstruktive të ndërmarra së fundmi nga qeveria kanë sjellë një zgjidhje të përkohshme për këtë rast. Sfidë mbetet gjetja e një zgjidhjeje më të qëndrueshme për familjet në fjalë dhe për familjet në situata të ngjashme, si dhe përmirësimi i integritetit të bashkësisë rome, përfshirë në fushat e arsimit, shëndetësisë, punësimit, mirëqenies sociale dhe strehimit social.

Në fund të shtatorit dhe në tetor 2012, një grup prej rreth njëzet ish-të përndjekurish politikë nisën një grevë urie, në një rrugë në qendër të Tiranës, duke kërkuar një pagesë me të shpejtë të kompensimit për viktimat e regjimit të kaluar komunist. Megjithëse detajet e sakta kontestohen, dy nga grevistët u dogjën dhe njëri si përfundim vdiq. Bashkë me aktorë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, Prezenca bëri thirrje për dialog mes qeverisë dhe grevistëve, për të ulur tensionin dhe për të gjetur një zgjidhje të pranueshme bashkërisht. Megjithëse një vendim gjyqësor e shpalli grevën të paligjshme, vendimi si i tillë nuk u zbatua; grevistët u shpërndanë vetë, në vijim të refuzimit të policisë për të lejuar ujë dhe mjekim në mjediset e grevës. Problemet themelore që nxitën grevën nuk janë zgjidhur përfundimisht, por ka shpresa të mëdha se qeveria e re do ta trajtojë këtë çështje.

Periodha përpara festimeve të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 2012, ndërkohë që shënoi një pikë kulmore në bashkimin dhe krenarinë kombëtare për qytetarët e Shqipërisë, u shoqërua nga një rritje e retorikës nacionaliste, duke krijuar shqetësim te disa prej fqinjëve të Shqipërisë dhe te bashkësia ndërkombëtare. Bashkë me partnerët ndërkombëtarë, Prezenca i nxiti udhëheqësit politikë që të mbanin parasysh se Shqipëria, në pjesën më të madhe të dy dhjetëvjeçarëve të fundit, ka luajtur një rol konstruktiv dhe stabilizues në rajon. Si përfundim, nacionalizmi nuk e ndikoi ndjeshëm fushatën dhe nuk u pasqyrua në rezultatin e zgjedhjeve.

Tani që Komisioni Evropian ka rekomanduar dhënien e statusit kandidat Shqipërisë për në BE dhe në pritje të vendimit të Këshillit Evropian, klasa politike dhe qytetarët e Shqipërisë

kanë rastin që ta përdorin këtë inerci pozitive për të kërkuar transformim në atdheun e tyre, në mënyrë që të mbyllet kapitulli i tranzicionit. Prezenca do të vazhdojë t'u japë zemër dhe të punojë aktivisht me aktorët përkatës për axhendën e reformave, në përputhje me mandatin e saj dhe në partneritet të ngushtë me qeverinë, aktorët e tjerë politikë dhe shoqërinë civile.

MJEDISI PROGRAMATIK DHE VEPRIMTARITË

Dimensioni politiko-ushtarak

Me gjithë përpjekjet e bashkërenduara për asistencë dhe përmirësimet graduale, standardet profesionale institucionale të **policisë** kërkojnë përfundim të mëtejshëm. Për të shtruar udhën që policia t'i përmbushë më mirë standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, asistencën e Prezencës për policinë është përqendruar kryesisht në dhënien e ekspertizës dhe trajnimit në nivele të ndryshme. Prezenca ka punuar ngushtë me aktorë të tjerë ndërkombëtarë, si Misioni i Asistencës Policore i Komisionit Evropian në Shqipëri (PAMECA), Programi Ndërkombëtar i Asistencës në Trajnim për Hetimet Penale (ICITAP) dhe Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim (SIDA), dhe ka marrë pjesë aktivisht në Konsorciumin Ndërkombëtar, një grumbullim i të gjitha grupeve të interesit të përfshira në asistencën policore dhe në rendin e së drejtës në Shqipëri. Trajnimi i qëndrueshëm policor ka qenë një fokus kryesor për Prezencën. Temat dhe sukseset kyçe gjatë vitit të shkuar janë të lidhura me teknikat e hetimit penal, si për policinë, ashtu dhe për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm, duke përfshirë aftësitë dhe strategjitë e vëzhgimit, hetimit dhe intervistimit, ku janë trajnuar mbi 20 oficerë të lartë policie. Së fundmi, Ministria e Brendshme ka ndërmarrë një përpjekje të madhe ristrukturimi për ta modernizuar dhe profesionalizuar shërbimin policor. Opozita, megjithatë, ka pretenduar për emërimet e paligjshme në majën e Policisë së Shtetit. Mbetet për t'u parë se çfarë ndikimi do të kenë këto ndryshime të rëndësishme në strukturë dhe në shpërndarjen e personelit, jo vetëm te programet e trajnimit të Prezencës, por edhe te rendimenti i policisë.

Si ushtria, ashtu dhe policia, kanë konstatuar nevojën për t'u përmirësuar në barazinë, diversitetin dhe përfshirjen e pakicave, sidomos në lidhje me bashkësinë romë. Si rrjedhojë, Prezenca i ka dhënë përparësi punës në ato fusha ku shpesh mungesa e mirëkuptimit është e dukshme, si intervistimi i viktimave dhe dëshmitarëve të mitur dhe lufta kundër dhunës në familje. Në vijim të një kursi në nivel strategjik për oficerë të lartë, trajnimi për një grup instruktorësh policie përforcoi qëndrueshmërinë dhe mundësoi përfshirjen e trajnimit për diversitetin në programet mësimore. Policia e ka përqaftuar idenë dhe tani ua jep programin e miratuar nga Prezenca të gjithë rekrutëve të rinj, gjatë trajnimit bazë. Me ndihmën e Prezencës, nismat e policisë me synim rekrutimin e grave kanë dhënë fryte pozitive, pas një fushate rekrutimi konkurrues dhe diskriminimi pozitiv. Mbi 500 gra aplikuan dhe rreth 240 përfunduan me sukses procesin për t'u bërë pjesë e policisë. Duhet bërë më shumë punë, megjithëkëtë, për t'i mbajtur këto gra dhe për të nxitur gra të tjera që të ndjekin shembullin e tyre.

Drejtuesit e lartë të policisë njohën nevojën për të përmirësuar aftësitë e brendshme drejtuese dhe kërkuan ndihmën e Prezencës për të kryer një program trajnimi. Fokusi fillestar ishte te drejtuesit e vijës së parë, të cilët punojnë me Policinë e Kufirit dhe Migracionit; kurse pasuese janë fokusuar te niveli i mesëm drejtues. Deri më sot, 60 punonjës policie kanë marrë pjesë në një kurs njëmuor, i akredituar nga Instituti i Udhëheqjes dhe Menaxhimit në Mbretërinë e Bashkuar. Edhe pse ky është një hap pozitiv, policia ende ka nevojë për një

ndryshim në kulturën e udhëheqjes nga lart-poshtë dhe për një fuqizim më të madh të vendimmarrjes operative.

Menaxhimi i kufirit është një çështje me interes të madh në Shqipëri dhe mbetet aspekti më thelbësor i bashkërendimit dhe bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar ndër të gjitha autoritetet dhe agjencitë që merren me sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë. Prezenca ndihmoi Policinë Kufitare dhe të Migracionit në hartimin e një plani veprimi në plotësim të Strategjisë së qeverisë për Menaxhimin e Integruar të Kufirit për periudhën 2013-2020.

Duke pasur parasysh rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar në trajtimin e rreziqeve transnacionale, Prezenca është përqendruar në kalimin e pengesave për bashkëpunim rajonal. Prezenca vijoi të ndihmonte autoritetet përmes ndërmjetësimit për të konsoliduar bashkëpunimin mes të gjitha agjencive shtetërore që punojnë me çështjet kufitare, duke përforcuar zbatimin e procedurave kufitare ndërkombëtare përmes trajnimit dhe harmonizimit të kontrolleve të kufirit të jashtëm. Diversiteti gjuhësor dhe kompetenca teknike (në zbatimin e procedurave kufitare ndërkombëtare, për shembull) janë një përparësi për të gjithë punonjësit e policisë që punojnë në pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë. Prezenca ka punuar, përmes trajnimit dhe sensibilizimit, për të përmirësuar standardet dhe aftësitë në këto fusha.

Ngritja e qendrave të përbashkëta të shkëmbimit të informacionit me dy nga fqinjët e Shqipërisë është një arritje e konsiderueshme, e cila u mbështet fort nga Prezenca, nëpërmjet këshillimit, ndërmjetësimit, logjistikës dhe trajnimit të specializuar. Qendra të tilla mundësojnë shkëmbimin e informacionit aty-për-aty në verifikimin e qytetarëve dhe automjeteve, ulin kohën e pritjes, rrisin besimin e ndërsjellë dhe përforcojnë bashkëpunimin mes dy shërbimeve policore, që sjell forcimin e sistemeve të sigurisë kufitare.

Policia e Shtetit ka rritur fokusin e saj në luftën kundër grupeve kriminale të përfshira në një mori veprimtarish kriminale, si në trafikimin e drogës, automjeteve dhe armëve, sidomos kundër atyre që prodhojnë dhe trafikojnë kanabis sativa brenda Shqipërisë. Për rrjedhojë, policia ka mundur të asgjësojë një numër të konsiderueshëm bimësh dhe të sekuestrojë një sasi të madhe hashashi. Rritja dramatike, siç raportohet, në sekuestrimin e heroinës dhe kokainës më 2012 është pozitive, por nxjerr në pah shkallën e problemit. Shumë mbetet për të bërë për të zvogëluar dhe goditur grupet kriminale të organizuara transnacionale, të cilat kalojnë mallra të paligjshme përmes Shqipërisë, si dhe për të çrrënjësuar qendrat e njohura të prodhimit vendas. Në mbështetje të kësaj përpjekjeje, më 2013 Prezenca filloi të zhvillonte trajnim për vëzhgimin e fshehtë për forcat speciale të policisë, të akredituar nga Instituti i Udhëheqjes dhe Menaxhimit.

Së bashku me Ministrinë e Mbrojtjes, Prezenca po jep mbështetje në **çmilitarizim** për të ulur rrezikun e shpërthimit apo rrjedhjes kimike aksidentale që kanoset nga rreth 90 tonë municion i tepërt dhe 80 tonë lëndë të dëmshme, që ruhen ende në kushte keqësuese. Falë pajisjeve të siguruara nga Prezenca përmes një projekti jashtëbuxhetor, proceset për çmontimin e municionit tani mund të ecin në vijimësi. Për më tepër, ka nisur faza e parë e një projekti për asgjësimin e të gjitha stokeve të lëndëve kimike në repartet ushtarake. Në çështjet ushtarake, Prezenca ka nxitur një qasje rajonale ndaj procesit të çmilitarizimit duke kërkuar bashkëpunim me Misionet e OSBE-së në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi; duke mbështetur pjesëmarrjen e Ministrisë së Mbrojtjes të Shqipërisë në takime rajonale; dhe duke shfrytëzuar kanalet institucionale rajonale.

Dimensionimi ekonomik dhe mjedisor

Reforma e pronës mbetet për Shqipërinë një çështje thelbësore, nga e cila kushtëzohet zhvillimi në fusha të tjera. Mungesa e një kuadri të qëndrueshëm politikash ka sjellë një pasiguri ligjore sa u përket të drejtave të pronarëve, shtimit të ndërtimeve të paligjshme dhe zhvillimit të parregulluar të tregut të pronave të paluajtshme, me pasoja negative për gëzimin e papenguar të së drejtës së pronës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Reforma e pronës ka ngecur në pjesën më të madhe të vitit të shkuar. Në vijim të përmbylljes së projektit jashtëbuxhetor të Prezencës për regjistrimin e pronës, Prezenca ka punuar së bashku me Delegacionin e Bashkimit Evropian, si donatori kryesor i projektit, për të maksimizuar përdorimin e gjetjeve dhe të të dhënave të projektit. Qeveria e re e ka shpallur zgjidhjen e situatës me pronat si një nga përparësitë e saj kryesore dhe është zotuar që do të ndjekë një qasje të konsoliduar. Konsensusi kombëtar dhe qëndrueshmëria e kuadrit institucional dhe ligjor janë të domosdoshëm për suksesin e kësaj reforme.

Në luftën kundër **korruptionit**, me gjithë angazhimin e qeverive të njëpasnjëshme dhe reformën ligjore përgjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, perceptimi i korruptionit në terren është rritur, sipas Transparency International. Gjatë vitit të shkuar u vërejt përgjithësisht një përparim i kufizuar në çështjet kundër korruptionit. Në një hap për t'u përshëndetur, Kuvendi miratoi, në shtator 2012, një paketë ndryshimesh kushtetuese që kufizon imunitetin e përgjithshëm nga ndjekja penale të deputetëve, gjyqtarëve dhe zyrtarëve të tjerë të lartë. Megjithëse ndryshimet e miratuara nga Kuvendi hoqën një pengesë madhore për hetimin e rasteve të supozuara të korruptionit, procedurat hetimore ende kërkojnë qartësim. Sfida mbetet për t'i shndërruar angazhimet në zbatim efektiv, me nivelin e duhur të transparencës dhe llogaridhënies dhe një bilanc bindës, përfshirë procedime të nivelit të lartë. Qeveria e re e ka shpallur luftën kundër korruptionit një përparësi kryesore dhe ka çuar për hetim dhe ndjekje penale disa zyrtarë për akuza korruptioni. Qeveria gjithashtu ka thënë se do të hartojë një strategji të re kundër korruptionit dhe plan veprimi përkatës. Organet shtetërore që merren me korruptionin nuk janë ende plotësisht të mbrojtura nga presioni politik dhe vuajnë nga kufizimi i burimeve njerëzore dhe financiare. Prezenca po i ndihmon autoritetet kombëtare që të zhvillojnë një kuadër institucional më efektiv për të parandaluar dhe luftuar korruptionin dhe pastrimin e parave. Rrjedhimisht, ka pasur përmirësime në komunikimin dhe bashkëpunimin mes institucioneve qendrore, si dhe një shtim të numrit të rasteve të denoncuar në prokurori, megjithëse rezultatet mbeten për t'u parë. Në bashkëpunim me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (ILDKP) dhe Institutin e Trajnimit të Administratës Publike, mbi 200 zyrtarë publikë dhe të zgjedhur vendorë u trajnuan për etikën, konfliktin e interesit dhe antikorrupsionin për të siguruar një zbatim efektiv të masave dhe mekanizmave kundër korruptionit. Për më tepër, Prezenca mbështeti hartimin dhe botimin e një manuali për pikat fokale të ILDKP-së në institucionet publike, për të përmirësuar parandalimin dhe hetimin e hershëm të rasteve të konfliktit të interesit.

Në luftën kundër **trafikimit në njerëz**, në një notë pozitive, në maj 2013 Shqipëria përmirësoi legjislacionin e saj penal kundër trafikimit, duke e sjellë gjerësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, përfshirë Konventën e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit. Prezenca shqyrtoi dhe bëri komente mbi projektlegjislacionin dhe kuadrin operativ me qëllim për të mundësuar një qasje të orientuar nga viktima, shumica e të cilave u pranuan. Përpjekjet për të ndjekur penalisht krimet e trafikimit në njerëz dhe për të mbrojtur personat e trafikuar kanë mbetur gjithsesi në nivel të ulët. Reagimi i zbatuesve të ligjit në hetimin e të gjitha formave të trafikimit në njerëz ka qenë i dobët, më së shumti për shkak të zëvendësimit të punonjësve të policisë të specializuar kundër trafikimit. Më 2012, Prokuroria e Krimeve të Rënda hetoi njëmbëdhjetë trafikantë të dyshuar, megjithëse vetëm një çështje u

regjistrua në Gjykatën e Krimeve të Rënda. Hetimi i rasteve të trafikimit në njerëz u kufizua kryesisht tek ato që përfshinin trafikimin për shfrytëzim seksual. Prezenca mori pjesë në një grup pune ekspertësh të Ministrisë së Brendshme për të analizuar ndjekjen penale të rasteve të trafikimit në njerëz në Shqipëri dhe për të diskutuar përmirësime të mundshme. Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit në Njerëz ngriti një grup pune për hetimin dhe gjykimin e çështjeve të trafikimit në njerëz, i cili konstatoi boshllëqe serioze në përgjigjen institucionale ndaj kësaj dukurie. Mbrojtja e personave të trafikuar është kryer më së shumti nga OJF, përmes projekteve të financuara nga donatorë. Në lidhje me shfrytëzimin për punë, Prezenca vazhdoi bashkëpunimin e frytshëm me Inspektoratin Shtetëror të Punës, duke hartuar udhëzime dhe një format intervistimi për punën e detyruar. Kjo po ndiqet nga një trajnim në punë për të dymbëdhjetë inspektoratet rajonale të punës dhe, më pas, duhet integruar në procedurat e inspektimit të punës. Sekuestrimi i pasurive të trafikantëve të njerëzve është një fushë e re fokusi për Prezencën, e bazuar në praktikatat më të mira të zhvilluara nga Sekretariati i OSBE-së. Një seminar ekspertësh, i organizuar bashkë me Njësinë e Çështjeve Strategjike Policore, nxori rekomandime për mundësimin e hetimit financiar të rasteve të trafikimit në njerëz dhe nxiti diskutime rreth përdorimit të pasurive të konfiskuara për të kompensuar viktimat e trafikimit.

Qeveria e re e ka renditur **reformën territoriale dhe administrative** si një përparësi kryesore, ndonëse kjo do të kërkojë konsultim të gjerë publik për të zhvilluar një vizion strategjik dhe plan veprimi të dakordësuar dhe një metodë për matjen e përparimit. Në vijë me *Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore* të Këshillit të Evropës, reforma duhet të garantojë pavarësinë politike, administrative dhe financiare të qeverive vendore. Më tej, është thelbësore që të merren masa që procesi i vendimmarrjes për këtë reformë të jetë transparent, gjithëpërfshirës dhe konsensual. Mekanizma konsultimi mes qeverisë vendore dhe shoqërisë civile rreth hartimit të politikave po zënë fill, sikurse dhe transparencja në procesin vendimmarrës. Njësitë e qeverisë vendore përballen me sfidën e ushtrimit të funksioneve të transferuara pa përgatitje dhe me burime financiare shumë të kufizuara. Sfidat më të mëdha kanë të bëjnë me zbatimin e politikave kombëtare në lidhje me planifikimin territorial, menaxhimin e ujit dhe mbetjeve dhe mirëqenien sociale. Prezenca ndihmoi Shoqatën e Komunave të Shqipërisë për të bërë një vlerësim të zbatimit të përgjegjësive të decentralizuara në nivel vendor, duke nxjerrë në pah pengesat dhe vështirësitë e reformës së decentralizimit. Rezultatet e vlerësimit dhe rekomandimet për zgjidhje të mundshme ndaj çështjeve me interes do të përfshihen në një dokument politikash, me synimin për të kontribuar në vendimmarrjen e qeverisë dhe Kuvendit. Prezenca mbështet dhe po punon ngushtë me qeverinë e re në nismat e saj për konsultime publike, për të hartuar reformën territoriale dhe administrative, përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse.

Në **qeverisjen mjedisore**, u vërejtën zhvillime në përfrimin e legjisllacionit, megjithëse sfidat vijnë lidhur me zbatimin e ligjit në terren. Përmirësimet në Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor dhe në përpjekjet e shtuara për konsultime me publikun do ta lehtësonin ndikimin e investimeve qeveritare në fushën e energjisë, minierave dhe infrastrukturës. Një raport i analizës së situatës për praktikatat ekzistuese dhe sfidat e industrive nxjerrëse, i porositur nga Prezenca, në bashkëpunim me Kanadanë, tregoi se të pakta janë ato kompani që respektojnë standardet mjedisore dhe se institucionet qeveritare nuk janë plotësisht të afta të sigurojnë respektimin e detyrimeve mjedisore kombëtare dhe ndërkombëtare për menaxhimin e burimeve natyrore. Megjithëse problemi i menaxhimit të mbetjeve është pranuar gjerësisht dhe numri i kompanive ricikluese në Shqipëri u rrit vitin e fundit, kjo nuk ka sjellë ende një përmirësim të menaxhimit të mbetjeve të ngurta në nivel kombëtar. Në një lëvizje që u përshëndet nga mjedisorët, por u kritikua nga industria ricikluese, Kuvendi shfuqizoi, më 10

tetor, importin e plehrave në Shqipëri, duke e nxjerrë kështu të panevojshëm referendumin për këtë çështje, të planifikuar për më 22 dhjetor.

Dimensioni njerëzor

Më 23 qershor 2013, zgjedhësit shqiptarë morën pjesë aktivisht në **zgjedhjet** për Kuvendin 140-vendësh. Në zgjedhje garuan gjashtëdhjetë e gjashtë parti politike² dhe dy kandidatë të pavarur. Me përjashtim të një incidenti vdekjeprurës, në afërsi të një qendre votimi në qarkun e Lezhës, dita e zgjedhjeve ishte, në përgjithësi, e qetë dhe e rregullt. Numërimi i fletëve të votimit u përmbyll brenda një kohe dukshëm më të shkurtër se në zgjedhjet e mëparshme, por, prapëseprapë, tej afatit ligjor. Ndonëse procesi i ankimeve dhe apelimeve u zgjat në nivelin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), ai u zhvillua brenda afateve ligjore në nivelin e Kolegjit Zgjedhor. Rezultatet e zgjedhjeve u shpallën zyrtarisht nga KQZ-ja më 6 gusht: koalicioni i majtë, i udhëhequr nga Partia Socialiste, fitoi 83 vende në parlament, ndërsa koalicioni i djathtë, i udhëhequr nga Partia Demokratike, fitoi 57 vende.³

Konstituimi i vonuar i KQZ-së vështirësoi përgatitjet në kohë për zgjedhjet, veçanërisht lidhur me përdorimin e teknologjive të reja të votimit. Projektet pilote për numërimin elektronik dhe identifikimin elektronik të zgjedhësve kaluan një fazë fillestare planifikimi kryer nga një kompani e specializuar, e kontraktuar për këtë qëllim. Pas testimit të të dyja sistemeve, KQZ-ja vendosi të mos i përdorte në zgjedhjet e 2013-s. KQZ-ja miratoi pjesën më të madhe të akteve lidhur me administrimin teknik të zgjedhjeve me vendimmarrje të njëzëshme. Megjithatë, një numër i vogël vendimesh të rëndësishme u mor sipas vijave partiake, përfshirë shpërndarjen e mandateve të deputetëve sipas qarqeve dhe përcaktimin e numrit të Zonave të Administrimit Zgjedhor. Përfundimisht, këto vendime u morën, përkatësisht, nga parlamenti dhe Kolegji Zgjedhor. Pas daljes së partisë Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) nga koalicioni, në prill 2013, parlamenti liroi nga detyra anëtarin e KQZ-së të propozuar nga LSI-ja dhe e zëvendësoi me një anëtar të propozuar nga një parti tjetër e koalicionit qeverisës. Pas kësaj, tre anëtarët e KQZ-së të propozuar nga opozita dhanë dorëheqjen në shenjë proteste. Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it vërejti se baza ligjore për shkarkimin e tij ishte e diskutueshme. Në vijim, KQZ-ja i administroi zgjedhjet vetëm me katër anëtarë. Misioni i OSBE/ODIHR-it, megjithatë, vlerësoi se korniza ligjore në tërësi ofroi një bazë të shëndoshë për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, se fushata zgjedhore ishte e gjallë dhe se përgatitjet teknike qenë të përshtatshme. Gjithashtu, OSBE/ODIHR-i vërejti se prania e qytetarëve dhe e vëzhguesve të partive përgjatë ditës së zgjedhjeve, përgjithësisht, e rriti transparencën. Megjithëkëtë, ndër sfidat kryesore qenë atmosfera e mosbesimit mes dy forcave më të mëdha politike; mjegullimi i vijës ndarëse mes institucioneve shtetërore dhe partive politike; mungesa e zbatimit efektiv të rregulloreve për median, si dhe mungesa e një procesi ndreqës efektiv dhe të rregullt ligjor për të zgjidhur ankesat zgjedhore. Ndryshe nga proceset e mëparshme zgjedhore, cilësia e përgjithshme e listës së zgjedhësve nuk u kundërshtua. Prezenca e mirëpret gatishmërinë e qeverisë, shprehur përmes Ministrisë së Punëve të Jashtme, për të zbatuar plotësisht rekomandimet e ODIHR-it dhe mbetet e gatshme t'i ndihmojë institucionet shqiptare në këtë drejtim.

Prezenca ndihmoi KQZ-në në forcimin e kapaciteteve të saj, përgjatë të gjithë procesit zgjedhor. Prezenca vijoi të drejtojë Grupin Sektorial të Punës për zgjedhjet, duke bashkërenduar rreth 1.5 milionë eurot, në formën e ndihmës teknike, që u dhanë nga njëmbëdhjetë donatorë. Në bashkëpunim me aktorë të tjerë ndërkombëtarë, Prezenca, në

² Gjashtëdhjetë e dy parti u grupuan në dy koalicione, ndërsa katër garuan më vete.

³ Sikurse përmendet te Vështirësimi i Përgjithshëm, për shkak të kalimit të mëvonshëm të një deputeti të opozitës, koalicioni i ri qeverisës tani ka 84 vende në parlament, ndërsa opozita 56.

janar 2013, mundësoi trajnimin e anëtarëve dhe stafit të lartë të KQZ-së për administrimin e zgjedhjeve dhe aftësitë menaxhuese. Përveç kësaj, së bashku me Këshillin e Evropës, Prezenca e ndihmoi KQZ-në në zhvillimin e një trajnimi për trajnerët me komisionerët zgjedhorë të nivelit të mesëm. Po ashtu, Prezenca e mbështeti KQZ-në në përmirësimin e strategjisë së saj trajnuese dhe të strategjisë për edukimin/informimin e zgjedhësve, si dhe e ndihmoi KQZ-në në zhvillimin e programeve për afrimin me zgjedhësit.

Prezenca mbështeti transparencën e rritur të punës së **Kuvendit** të Shqipërisë, duke organizuar një sërë forumesh diskutimi nëpër qarqe, me deputetë të qeverisë dhe të opozitës, me pjesëmarrjen e rreth 350 veprimtarëve të shoqërisë civile, studentëve, përfaqësuesve të biznesit dhe qytetarëve të tjerë, me synimin për të krijuar besim mes forcave politike, për të shtuar dijet qytetare dhe për të stimuluar kulturën shoqërore demokratike të vendit. Në këtë drejtim, Prezenca i kushtoi rëndësi të veçantë pjesëmarrjes së grave dhe lidhjes së deputeteve me zonat e tyre zgjedhore. Temat e diskutimit përfshinë komunikimin e përmirësuar mes deputetëve dhe zonave zgjedhore, përfaqësimin gjinor në strukturat vendimmarrëse dhe konsultimin publik gjatë procesit ligjvënës. Në bashkëpunim me ODIHR-in, Prezenca mbështeti, gjithashtu, një diskutim për standardet etike të deputetëve, i cili u ndoq nga një vlerësim i standardeve etike për Kuvendin e Shqipërisë. Tani, Prezenca po angazhohet me legjislaturën e re për miratimin e mundshëm të një kodi etike për deputetët. Gjithashtu, Prezenca mundësoi pjesëmarrjen shqiptare në një veprimtari rajonale, ku u shkëmbyen përvojat dhe praktikat më të mira lidhur me marrëdhëniet me zonat zgjedhore. Diskutimet në këtë takim, tok me këshillat e ofruara nga Prezenca, ushqyen një ligji të ri, të miratuar në maj 2013, i cili parashikon për herë të parë zyra në zonat zgjedhore, që deputetët të mund të rrisin aksesin dhe komunikimin me zonat e tyre. Prezenca po ndihmon tani Kuvendin për t'i ngritur këto zyra. Me qëllim për të përmirësuar cilësinë e raportimit të mediave për çështjet kuvendore, Prezenca mundësoi një program shkëmbimi për gazetarët shqiptarë me kolegët e tyre sllovenë, të përqendruar te raportimi parlamentar dhe transparencja e procesit legjislativ. Trajnimi çoi në një përmirësim cilësor të raportimeve të gazetarëve, veçanërisht lidhur me përmbajtjen dhe analizën; gazetarët, gjithashtu, shfaqën një njohje më të mirë dhe interes të shtuar lidhur me çështjet e transparencës dhe lirisë së informimit.

Ligji i **medias**, i cili rrinte pezull prej shtatë vjetësh, u kalua, më në fund, nga parlamenti, në mars 2013. Rekomandimet e Prezencës për të depolitizuar organin e mbikëqyrjes së medias audiovizive dhe transmetuesin publik, fatkeqësisht, nuk u morën parasysh, duke krijuar kështu rrezikun që të dyja institucionet të bëhen vegla politike të shumicës qeverisëse, sikurse vuri në dukje edhe Përfaqësuesja e Lirisë së Medias, fill para miratimit të ligjit. Qeveria e re ka sinjalizuar përkushtimin e saj për të siguruar pavarësinë e rregulluesit të transmetimeve audiovizive dhe për të ristrukturuar transmetuesin publik, për të siguruar një menaxhim profesional dhe politikisht asnjës. Procesi i dixhitalizimit vijoi të vonohet, megjithatë, duke vështirësuar mundësinë e Shqipërisë për të përfunduar kalimin në transmetimet numerike brenda afatit të qershorit 2015. Konferenca e këtij viti për Median në Evropën Juglindore, bashkorganizuar në Tiranë, në shtator 2013, nga Përfaqësuesja e Lirisë së Medias dhe Prezenca, i kushtoi një seminar të posaçëm disa aspekteve të dixhitalizimit, nga ekspertë të njohur të fushës.

Situata e **barazisë gjinore** u përmirësua gjatë vitit të shkuar. Qeveria e re ka bërë një përpjekje të veçantë në këtë drejtim: nga 20 ministrat aktualë, gjashtë janë gra. Në parlament ka tani 25 deputete (18%) dhe kjo shifër pritet të rritet kur ministrat të heqin dorë nga mandati dhe të zëvendësohen nga kandidatë të listave të partive. Megjithatë, asnjëra nga partitë e mëdha nuk e përmbushi plotësisht kuotën gjinore për përfshirjen e grave në listat e kandidatëve; për më tepër, gjrobat e përcaktuara në ligj për shkelje të tilla janë mjaft të ulëta

dhe nuk duket se ofrojnë shtysën e nevojshme për respektimin e kuotës. Përmirësime të mëtejshme nevojiten për zbatimin e plotë të ligjit “Për barazinë gjinore”, të vitit 2008, përfshirë emërimin e pikave fokale për barazinë gjinore, në nivelin e qeverisë qendrore dhe vendore. Prezenca promovoi praktikat më të mira për përfshirjen e faktorit gjinor në nivelin e qeverisë vendore dhe pati në objektiv grupe specifike, përfshirë këshilltaret bashkiake, kryetaret e bashkive dhe komunave dhe punonjësit e barazisë gjinore; veç kësaj, u krijua një grup trajnuesish kombëtarë për gjininë dhe vetëqeverisjen vendore, i cili do të merret me nevojat për trajnim vendor në të ardhmen.

Shoqëria civile qe aktive në monitorimin e zgjedhjeve parlamentare të 23 qershorit. Dy koalicione organizatash të shoqërisë civile vëzhguan procesin zgjedhor në afatin e gjatë dhe të shkurtër dhe prodhuan raporte dhe rekomandime të vlefshme, përfshirë ato për pjesëmarrjen e zgjedhësve me aftësi të kufizuara. Megjithatë, kapaciteti i shoqërisë civile është përgjithësisht disi i ulët, veçanërisht në zonat rurale dhe ka nevojë për mbështetje të mëtejshme, për të qenë në gjendje të përmbushë rolin e saj si partnere strategjike e qeverisë në vendimmarrje. Po ashtu, OJF-të perceptohen shpesh si të lidhura politikisht, duke dobësuar kështu legjitimitetin e rolit të tyre ruajtës. Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, e financuar nga shteti, themeluar në 2010-n, ende nuk ka mundur t’i trajtojë kënaqshëm këto sfida. Prandaj, Prezenca i kushtoi vëmendje të veçantë fuqizimit të pjesëmarrjes qytetare, veçanërisht të të rinjve. Një sërë veprimtarish u përqendruan në rritjen e aftësive debatuese të studentëve, për t’i përgatitur për diskutime të strukturuar me autoritetet vendore dhe me deputetë. Duke fuqizuar dhe mobilizuar qytetarët për t’i trajtuar këto çështje, së pari në nivel vendor e pastaj në atë kombëtar, Prezenca synon të përmirësojë transparencën e mekanizmave vendimmarrës dhe të konsultimit vendor. Një konkurs esesh me temën “Çfarë është demokracia për mua?”, ndër nxënës të shkollave të mesme, ngjalli interes dhe pjesëmarrje të gjerë. Përveç këtyre, veprimtaritë për rritjen e ndërgjegjësimit promovuan përfshirjen e grupeve në nevojë në jetën politike dhe publike.

Sikurse në vitet e kaluara, autoritetet u përqendruan kryesisht në reformimin e kornizës ligjore, duke i kushtuar më pak rëndësi zbatimit të ligjit. Kjo qasje vijon të rëndojë përparimin në çështjet e shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut. Arritjet në **sistemin e drejtësisë**, vitin e shkuar, konsistuan, në thelb, në miratimin e legjislacionit të ri. Në tetor 2012, Kuvendi miratoi ndryshimet në ligjin “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, që reformoi procedurën disiplinore për avokatët. Prezenca bëri komente të shumta për këto ndryshime, të cilat u morën parasysh pjesërisht. Në prill 2013, Kuvendi miratoi ligjin “Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë”, i cili përcakton parimet e administratës gjyqësore dhe njëson metodat e punës në të tëra gjykatat. Ligji krijon një shërbim civil gjyqësor, duke u dhënë disa pozicioneve në administratën gjyqësore status të njëjtë me atë në shërbimin civil, gjë që i bën më të pavarura, të qëndrueshme dhe meritokratike. Prezenca bëri komente për këtë projektligj, të cilat u morën, përgjithësisht, parasysh. Po në prill, Kuvendi miratoi ndryshimet në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”. Ndonëse ndryshimet mund ta rrisin efikasitetin e Gjykatës së Lartë, ka ende dyshime nëse ato do të sjellin përmirësimet e parashikuara në pavarësinë e Gjykatës së Lartë, për shkak të mundësisë së vazhdueshme të ndikimeve politike në proces. Miratimi nga Kuvendi i emërimit të tre gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese nga Presidenti, në prill dhe maj 2013, qe një zhvillim pozitiv, që i dha fund një ndërçështjeve të emërimeve të propozuara nga Presidenti i mëparshëm në vitin 2010.

Në qershor 2013, hynë në fuqi ndryshimet në **Kodin Penal**. Ato shtuan apo ndryshuan 41 nene me synim përforcimin e luftës kundër krimit, duke përfshirë, ndër të tjera, dënime më të ashpra për autorët e vrasjeve të punonjësve të policisë dhe për vrasësit e bashkëshortëve,

vrasjet e motivuara nga gjakmarrja dhe për zotërimin e paligjshëm të armëve. Kodi Penal tani përmbush një sërë detyrimesh ndërkombëtare të Shqipërisë, të cilat nuk qenë të pasqyruara në ligjin vendas, si Konventën e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Prezenca kontribuoi me komente të qenësishme në projektligj, për të sqaruar dispozitat dhe për të përmirësuar teknikën legjislative. Këto komente u reflektuan, në një masë të madhe, në variantin përfundimtar të ndryshimeve. Për më tepër, Prezenca mbështeti ndjeshëm rishikimin e parashikuar të Kodit të Procedurës Penale, duke dhënë ekspertizë për planifikimin e përgjithshëm të procesit të reformave dhe duke dhënë kontribut thelbësor për raportin e task forcës, në të cilin bazohet reforma.

Në shtator 2013, hynë në fuqi ndryshimet në **Kodin Civil dhe në Kodin e Procedurës Civile**, miratimi i të cilave u parapri nga një proces konsultimi me shtrirje të kufizuar. Ndryshimet synuan krijimin e efikasitetit dhe transparencës së procesit civil. Prezenca bëri komente të zgjeruara mbi ndryshimet dhe shumica e tyre u përfshi në tekstin përfundimtar. Disa ndryshime u bazuan në rekomandimet e bëra nga Prezenca në raportin e saj për procesin civil “Drejt drejtësisë”. Ky raport, i diskutuar gjerësisht me gjykatës, avokatë dhe kancelarë gjykatash, u botua nga Prezenca në dhjetor 2012, si rezultat i monitorimit që ajo i bëri procesit civil përgjatë disa viteve. Raporti sugjeron rekomandime për një proces civil më efikas, transparent dhe të arritshëm. Prezenca, në vijim të përpjekjeve të saj për reformën e procesit civil, po harton aktualisht ndryshime të tjera ligjore, si dhe po mbështet, së bashku me JuST-in e USAID-it, një projekt pilot në Krujë për të vënë në provë rekomandimet e “Drejt drejtësisë” me profesionistët.

Një hap pozitiv dhe i rëndësishëm lidhur me **reformën e administratës publike** u hodh përmes miratimit nga ana e Kuvendit, në maj 2013, pas një kohe të gjatë, të ligjit “Për nëpunësin civil”. Ligji i ri pritet të formojë bazën për një administratë publike meritokratike dhe transparente, ndër të tjera përmes parashikimit të procedurave konkurruese të punësimit, të bazuara te meritat, për të frenuar punësimet dhe pushimet nga puna për motive politike e personale. Më 30 shtator, pas konsultimeve me bashkësinë ndërkombëtare, Këshilli i Ministrave vendosi ta shtyjë me gjashtë muaj fillimin e efekteve të ligjit, nga hyrja në fuqi e ligjit më 1 tetor, deri më 1 prill 2014. Qeveria e paraqiti shtyrjen si opsionin më të mirë për të shmangur një boshllëk ligjor, që do të ishte krijuar nëse efektet e ligjit do të fillonin në mungesë të akteve të nevojshme nënligjore për zbatimin e tij. Këshilli i Ministrave përdori një “akt normativ që ka fuqinë e ligjit”, sipas nenit 101 të Kushtetutës, i cili lejon marrjen e masave të përkohshme në rast nevojë dhe urgjence. Ky akt normativ, siç e kërkon Kushtetuta, u miratua më pas nga Kuvendi. Partia kryesore e opozitës bëri publik shqetësimin e saj për shtyrjen, duke shprehur frikën e spastrimeve të mundshme në administratën publike. Më 3 tetor, ligjvënësit e opozitës iu drejtuan Gjykatës Kushtetuese me kërkesën për shfuqizimin e aktit normativ. Prezenca pati bërë komente mbi projektligjin, duke vënë në dukje, veçanërisht, rëndësinë e një Komisioni të Shërbimit Civil të pavarur dhe duke rekomanduar mbajtjen e këtij institucioni. Si pasojë, institucioni u ruajt, por Komisioni do të transformohet në Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil. Institucioni do të vijojë të mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit për shërbimin civil nga institucionet shtetërore të përfshira në sistemin e shërbimit civil, numri i të cilave do të rritet ndjeshëm me fillimin e zbatimit të ligjit.

Dy **procese gjyqësore të bujshme**, të cilat Prezenca i ndoqi nga afër, mbetën në qendër të vëmendjes së publikut. Në çështjen e Gërdecit, lidhur me shpërthimin në një punishte çmontimi municionesh, që vrau 26 njerëz në 2008-n, Gjykata e Apelit e Tiranës, në shkurt 2013, mbajti në fuqi shumicën e dënimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së parë. Apelet e paraqitura nga prokuroria dhe nga disa prej të pandehurve u hodhën poshtë nga Gjykata e

Lartë, në korrik 2013. Në një gjyq tjetër për të njëjtën ngjarje, megjithëse Gjykata Kushtetuese e udhëzoi Gjykatën e Lartë të rishikonte paditë penale private të ngritura nga familjet e viktimave, gjyqi nuk u zhvillua, për shkak të amnistisë së dhënë me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë. Në proceset penale pas ngjarjeve të dhunshme të 21 Janarit 2011 mes protestuesve dhe policisë, të cilat sollën katër të vdekur dhe disa të plagosur, Gjykata e Rrethit Tiranë, pas 41 seancash, në shkurt 2013, shpalli të pafajshëm dy pjesëtarët e Gardës Kombëtare, të akuzuar për vrasjen e tre protestuesve. Gjykata e Shkallës së Parë e Tiranës vendosi se akuza e ngritura nga prokuroria për vrasje me dashje nuk mund të vërtetoheshin dhe se gjykata nuk ishte në gjendje të bënte një cilësim të ndryshëm juridik të fakteve. Gjykata e Apelit e Tiranës e ndryshoi vendimin për shpalljen të pafajshëm të dy të pandehurve dhe, në shtator 2013, dha për ta masa relativisht të shkurtra me burgim për vrasje pa dashje, duke argumentuar se, megjithëse vrasja me dashje nuk mund të vërtetohet, gjykata e shkallës së parë duhej të kishte ndryshuar cilësimin juridik të fakteve. Prokuroria, e cila kishte kërkuar dënime me 21 dhe 23 vjet për të pandehurit, e apeloj vendimin në Gjykatën e Lartë.

Roli gjithnjë e më i fortë dhe aktiv i institucioneve kombëtare të të **drejtave të njeriut**, veçanërisht i Avokatit të Popullit, në rritjen e ndërgjegjësimit për shkeljet e të drejtave të njeriut dhe promovimin e mbrojtjes së të drejtave, mund të shihet si një zhvillim shumë pozitiv. Megjithatë, Avokati i Popullit ende vuan për t'u dëgjuar nga institucionet; me shpresë, shenjat për një hapje dhe mbështetje të re nga Kuvendi, në veçanti, do të çojnë në marrjen parasysh të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Ndonëse përgjithësisht korniza e të drejtave që sigurojnë mbrojtjen nga aktorët shtetërorë ekziston, ashtu si në vitet e kaluara, pak përparim u shënuar në mbrojtjen e të drejtave të grupeve në nevojë, veçanërisht të **pakicave** rome dhe egjiptiane. Veçanërisht shqetësues ishte numri në rritje i nxjerrjeve nga banesa dhe zhvendosjes së familjeve rome, në mungesë të një strehimi alternativ, si dhe përgjigjja e pamjaftueshme nga autoritetet përkatëse. Rasti më serioz ishte situata e 37 familjeve rome, të përbëra nga 96 fëmijë dhe 114 të rritur, të detyruara të lënë banesat në Tiranë për shkak të një projekti ndërtimi privat, të cilat, më pas, e ngritën kampin buzë një rruge kryesore. Avokati i Popullit, i mbështetur nga Prezenca, bëri thirrje për përgjigje institucionale dhe organizoi disa tryeza për të diskutuar zgjidhje afatshkurtra dhe afatmesme. Përgjigjja proaktive e Ministrisë së re të Mirëqenies Sociale, e mbështetur nga Prezenca me këshillim teknik dhe ligjor, për t'u gjetur një strehim alternativ këtyre familjeve dhe përkushtimi i saj i shprehur për të kërkuar zgjidhje afatgjata për rastet e ngjashme, është një zhvillim shumë pozitiv. Prezenca, në bashkëpunim me projektin e ODIHR-it "Praktikat më të mira për integrimin e romëve" mundësoi, gjithashtu, një seminar këshillimor rreth nxjerrjes së romëve nga banesa dhe për banesat sociale, ku morën pjesë aktorët shtetërorë përgjegjës, institucione kombëtare të të drejtave të njeriut dhe OJF, për t'i dhënë një zgjidhje të përbashkët problemit të zvarritur të strehimit social të romëve. Po ashtu, Prezenca trajnoi Policinë e Shtetit për çështje të barazisë dhe të diversitetit, për të parandaluar sjelljen diskriminuese të policisë.

Me sa mundi të konstatonte Prezenca, pas zhvillimit të një studimi në 11 nga 22 **burgjet** e vendit, gjendja e përgjithshme e kushteve në burgje është përmirësuar, veçanërisht mbipopullimi është zvogëluar, kryesisht për shkak të një amnistie dhe të hapjes së mjediseve të reja të paraburgimit. Sistemi i ri i monitorimit elektronik të të dënuarve filloi nga puna në mars 2013 dhe pritet ta ulë edhe më mbipopullimin. Prezenca mbështeti hartimin e kornizës së duhur ligjore për këtë sistem, si dhe ngritjen e një mekanizmi pilot të monitorimit elektronik. Duke njohur nevojën për të standardizuar praktikën e informimit të të dënuarve për të drejtat dhe detyrimet e tyre me hyrjen në burg, Prezenca mbështeti promovimin e të drejtave të personave në institucionet e vuajtjes së dënimit, përmes botimit të një broshure për

të burgosurit dhe të paraburgosurit. Për më tepër, Prezenca mbështeti Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në organizimin e një Dite për të Drejtat e Njeriut, për promovimin e të drejtave të personave në institucionet e vuajtjes së dënimit. Shërbimi i Provës ka vijuar të njohë përmirësime, përfshirë rritjen e mëtejshme të numrit të personelit. Prezenca trajnoi punonjësit e rinj të shërbimit të provës, si dhe ofroi trajnim për punonjësit socialë lidhur me çështjet e shërbimit të provës. Po ashtu, Prezenca mundësoi përmirësimin e bashkëpunimit mes Shërbimit të Provës dhe qeverisë vendore. Reforma në drejtësinë për të mitur ka ngecur që në 2009-n. Prezenca është e shqetësuar për pasojat për të drejtat e njeriut që sjell fakti se burgimi mbetet metoda e parapëlqyer e trajtimit të të miturve që shkelin ligjin. Kjo është një temë që do të ketë nevojë për vëmendje dhe rëndësi të veçantë të vijueshme në të ardhmen e afërt.

Ndërsa korniza ligjore për **mbrojtjen e fëmijëve** ekziston, bashkërendimi mes aktorëve të ndryshëm, të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve, mbetet i pamjaftueshëm dhe shumë njësi për mbrojtjen e tyre ende nuk funksionojnë. Prezenca zhvilloi trajnime pilote për mbrojtjen e fëmijëve, me një spektër të gjerë profesionistësh, për të nxitur bashkëpunimin mes aktorëve të ndryshëm. Veçanërisht shqetësuese mbetet çështja e dhunës së përhapur në familje, siç tregon edhe shifra e vrasjeve në banesë – 28 në 2012-n, sipas statistikave të policisë. Për të rritur ndërgjegjësimin, Prezenca mbështeti një sërë veprimtarish dhe projektesh për dhunën në familje dhe ribotoi e shpërndau një manual udhëzues për të ndihmuar viktimat e dhunës në familje të kërkojnë masa ligjore. Përveç kësaj, Prezenca ka nxitur, si pjesë e qasjes së policimit në komunitet, një nismë për të bashkuar ekipet institucionale shumëpartnerëshe, përmes udhëheqjes dhe shtysës së efektshme të Policisë së Shtetit dhe bashkive, të cilat janë shpesh të parat në ndërhyrje.

Riintegrimi i plotë në shoqëri i **ish-të përndjekurve politikë** mbetet shqetësim. Në kuadër të qëllimit të përgjithshëm të edukimit për të drejtat e njeriut, Prezenca organizoi takime mes studentëve dhe ish-të përndjekurve politikë, në katër universitete. Takimet u përqendruan në rritjen e ndërgjegjësimin të studentëve lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut gjatë regjimit komunist në Shqipëri.

VËSHTRIM DREJT SË ARDHMES

Publiku shqiptar ka tani pritshmëri të mëdha, veçanërisht për standardet demokratike, shtetin e së drejtës dhe zhvillimin ekonomik. Qeveria e re ka paraqitur një program ambicioz për t'i realizuar këto pritshmëri dhe Prezenca është tashmë aktive në ofrimin e ekspertizës dhe të mbështetjes praktike, në veprimtaritë që janë plot sfida të vështira dhe interesa të gërrshetuar. Kontributi konstruktiv i opozitës është i domosdoshëm për konsolidimin e mëtejshëm të demokracisë shqiptare dhe Prezenca do të vijojë të jetë në kontakt të baraspeshuar dhe të ngushtë me të gjithë aktorët politikë, si dhe do të vijojë të punojë me të gjitha palët për të zhvilluar më tej kapacitetet e Kuvendit.

Në përgjithësi, Shqipëria ka struktura institucionale dhe legjislativë të kënaqshme dhe strategjia e Prezencës parashikon një kalim të vëmendjes nga ndërtimi i institucioneve, në fushat ku sfidat janë më të mëdha: zbatimi i njëmendtë dhe i paanshëm i ligjit, funksionimi efektiv dhe i mirëfilltë i institucioneve dhe një marrëdhënie besimi me qytetarët e mes kundërshtarëve politikë.

E njohur si kontribuese e rëndësishme e paqes dhe stabilitetit dhe si një aktore bashkëpunuese dhe konstruktive në rajon, Shqipëria po fuqizon rolin e saj si Shtet pjesëmarrës i OSBE-së,

duke pritur Takimet e Vjeshtës të Asamblesë Parlamentare, në tetor 2012, Konferencën e Nivelit të Lartë për Tolerancën e Diskriminimit, në maj 2013, si dhe Konferencën e Medias në Evropën Juglindore, në shtator 2013. Prezenca do ta përkrahë aspiratën e shprehur të vendit për të marrë përsipër më shumë përgjegjësi ndërkombëtare, në nivele dhe formate të ndryshme.

Sfidat që mbeten për konsolidimin e demokracisë dhe integrimin e mëtejshëm ndërkombëtar janë të brendshme, në mendësi dhe në funksionim: trajta e ardhshme e vendit, shpejtësia, efikasiteti dhe qëndrueshmëria e reformave varen shumë nga vullneti dhe përkushtimi i të gjithë aktorëve politikë në Shqipëri. Sikurse tregon vizioni dhe strategjia e saj, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri u ofron institucioneve dhe qytetarëve të vendit partneritetin e saj të sinqertë – jo ndërhyrje, por një përkushtim të çiltër e të drejtuar nga rezultatet, në fusha të përzgjedhura ku ajo ofron kontribut të spikatur që plotëson atë të partnerëve – për t'i ndihmuar në përmbushjen e aspiratave të tyre të vyera.